



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

*Ruaj traditën,
fito të ardhmen*



PROJEKTI

“MENAXHIMI I INTEGRUAR DHE PASTRIMI I ZONËS BREGDETARE”

PROGRAMI “RUAJTJA DHE ZHVILLIMI I FSHATRAVE BREGDETARE” (CVCDP)

PROGRAMI “ÇATITË DHE FASADAT”

***Udhëzime për Pronarët e Shtëpive
mbi Aplikimin në Program
për vitin 2012***

**THIRRJA E KATËRT PËR APLIKIME
(18 Korrik – 18 Gusht, 2012)**



MINISTRIA E PUNEVE
PUBLIKE DHE TRANSPORTIT



BANKA BOTËRORE



Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, nëpërmjet Projektit “Menaxhimi i Integruar dhe Pastrimi i Zonës Bregdetare” (ICZMCP) ju fton të merrni pjesë në Programin “Çatitë dhe Fasadat” si pjesë e Programit “Ruajtja dhe Zhvillimi i Fshatrave Bregdetare” – CVCDP, (nënkomponenti B.4 i ICZMCP), i cili është duke u zbatuar në zonën Bregdetare Jugore të Shqipërisë.

Bregdeti Jugor ka peizazhe dhe cilësi të veçanta, që mund të nxisin zhvillimin ekonomik. Të integruar organikisht në këtë peizazh, fshatrat tradicionale të rajonit, formojnë një shprehje unike të arkitekturës tradicionale, që dallon nga shtrirja e tyre dhe përdorimi i materialeve lokale të ndërtimit. Tërheqja karakteristike vizuale e këtyre fshatrave është një pjesë thelbësore e peizazhit të zonës, por ato janë në rrezik për t'u rrënuar, nëse traditat e ndërtimit dhe materialet lokale abandonohen në favor të stileve universale dhe materialeve moderne artificiale.

Programi “Çatitë dhe Fasadat” (C&F) ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e arkitekturës tradicionale të Bregdetit Jugor dhe është hartuar për të shtuar kushtet për ruajtjen e kësaj trashëgimie të rëndësishme kulturore.



Ekipi i Zbatimit në Vlore (IT Vloa) është përgjegjës për zbatimin e Programit “Çatitë dhe Fasadat”. Nëpërmjet kësaj broshure ju ftojmë të merrni pjesë në këtë Program dhe të përfitonit nga asistencat Teknike dhe Financiare dhe të kontribuoni në zbatimin me sukses të tij.

Programi “Çatitë dhe Fasadat”, si pjesë e Programit “Ruajtja dhe Zhvillimi i Fshatrave Bregdetare” është përqendruar në asistencë të synuar dhe mbështetje financiare për pronarët e banesave tradicionale të përshtatshme për riparimin e çatave dhe rigjallërimin e fasadave të tyre, në përputhje me teknikat dhe materialet tradicionale. Programi “Çatitë dhe Fasadat” do të drejtojë, gjithashtu, nismën për Programin “Fjetje dhe Mëngjes” (F&M), që do të financojë pjesërisht përshtatjen modeste të pjesëve të brendshme të banesave me kushtet e jetesës moderne, në mënyrë që të zgjerohet produkti turistik dhe të adresojë mungesat në ofrimin e shërbimeve të mikpritjes në zonën Bregdetare.

Kultura është një burim për zhvillimin ekonomik dhe social. Mundësia për të nxjerrë të ardhura nga pasuritë kulturore krijon punësim, redukton varfërinë, nxit zhvillimin e sipërmarrjes për njerëzit në nevojë, edukon investimin privat dhe krijon burime për ruajtjen mjedisore dhe kulturore.

Në këtë broshurë ju do të gjeni informacion mbi objektivat specifike të këtij Programi të veçantë, përmbajtjen e tij, Strukturat e Zbatimit dhe procedurat e Aplikimit dhe Financimit. Së bashku me këtë broshurë do të gjeni, gjithashtu, një Formular për “Shprehje Interesi”. Ne jemi të bindur se kontributi i Autoriteteve Lokale dhe Komunitetit të zonës Bregdetare, do të jetë vendimtar për arritjen e qëllimit tonë të përbashkët në zhvillimin social dhe ekonomik të zonës Bregdetare Jugore, nëpërmjet zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm, në harmoni me mjedisin dhe kulturën lokale.

Aktivitetet kryesore: Programi “Çatitë dhe Fasadat” vepron përmes një aplikimi konkurrues dhe transparent dhe një procesi përzgjedhjeje. Një studim i përgjithshëm është realizuar në fillimin e projektit për fshatrat e përzgjedhura tradicionale të Bregdetit të Jugut (shih komunitetet e synuara) për të vlerësuar përqindjen e shtëpive, që kanë nevojë për riparime të Çative (përfshirë ulluqet) dhe Fasadave (duke përfshirë dyert dhe dritaret). Bazuar në sa më sipër, Programi parashikon mbështetje për aktivitetet e mëposhtme: (i) ofrimin e asistencës për plotësimin e Formularit të Aplikimit, (ii) projektin Arkitekturor dhe Inxhinierik (pa pagese), (iii) bashkëfinancim për riparimin e Çative dhe Fasadave, i disponueshëm për një maksimum prej 75 shtëpish, (iv) një iniciative eksperimentale “Fjetje dhe Mëngjes” (F & M) për të bashkëfinancuar përmirësime të brendshme në një numër shtëpish, i disponueshëm për një maksimum prej 20 shtëpish. Programi procedon nëpërmjet thirrjeve për aplikime. Kjo është thirrja e Katërt për aplikime. Nga tre thirrjet e proceduara 44 aplikime për Ç&F dhe 4 aplikime për F&M janë miratuar nga Komitetet e Nënprojekteve në Bashkinë Himarë dhe Komunën Lukovë. Aktualisht, pritet fillimi i zbatimit të punimeve për 10 shtëpi të përzgjedhura nga thirrja e Parë.



Përpara se të aplikoni: Ju lutemi, rezervoni kohë për të lexuar këto udhëzime që te jeni të qartë për procedurat, që duhen ndjekur dhe kriteret, që duhen plotësuar.

Kërkesat dhe propozimet duhet të dorëzohen tek IT Vlorë dhe janë subjekt i një procesi përzgjedhjeje dhe miratimi nga Projekti dhe Komitetet e Miratimit të Nënprojekteve pranë Pushteteve Lokale. Programi “Çatitë dhe Fasadat” do të financojë kërkesat e miratuara, që përputhen dhe plotësojnë kriteret e Programit “Ç&F”.

Strukturat e zbatimit: Programi “Çatitë dhe Fasadat” administrohet nga Njësia e Koordinimit të Projektit (PCU) e ICZMCP dhe nga Ekipi i Zbatimit në Vlorë (IT Vlorë). PCU është përgjegjëse për Programin në tërësi, veçanërisht, për menaxhimin financiar, disbursimin dhe të gjitha raportimet. IT Vlorë është përgjegjës për mbikëqyrjen e aktiviteteve të Programit, informimin dhe procesin e aplikimit, asistencë për aplikantët, procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes dhe monitorimin e aktiviteteve të Programit. Autoritetet Lokale dhe Kryesitë e fshatrave, me anëtarët e komuniteteve të tyre po kontribuojnë në Programin “Ç&F”, duke ofruar kontributin e tyre gjatë të gjitha fazave të Programit dhe veçanërisht mbështetje për IT Vlorë për përhapjen e informacionit, identifikimin e shtëpive dhe, me pas, në zbatimin e punimeve.

Komunitetet e përzgjedhura

Duke parë rrezikun për zhdukjen pothuajse të plotë të ansambleve përfaqësuese të vlerave të arkitekturës tradicionale në fshatrat e Bregdetit të Jugut dhe në mënyrë që të ketë një ndikim me të madh në drejtim të demonstrimit pamor dhe të qëndrueshmërisë, Programi “Çatitë dhe Fasadat” do të zbatohet në fshatrat/Komunitetet e përzgjedhura, ku ka një sasi të konsiderueshme të banesave tradicionale, konkretisht nga: Dhërmi i Vjetër, Qeparo i Vjetër, Ilias, Vuno dhe Himarë e Vjetër (në Bashkinë Himarë) dhe Piqeras, Nivicë dhe Leksht (lagje në Lukovë) (në Komunën Lukovë). Një aplikant mund të marrë pjesë dhe të aplikojë për të dy Programet: “Çatitë dhe Fasadat” dhe “Fjetje e Mëngjes”.

Kush mund të aplikojë

Pronaret e shtëpive, banorë të fshatrave të përzgjedhur, që zotërojnë një shtëpi, që mbart vleratë traditës, janë të pranueshëm për të aplikuar, për atë kohë sa ata përbushin kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes (shih me poshtë).

Shuma e Financimit dhe procedurat

Për riparimin e Çatave dhe Fasadave, mbështetja financiare nga Programi do të jetë deri në 70 % të koston së restaurimit (përfshirë TVSH), me një maksimum deri në 7.000 US \$ për aplikim. Për Programin “Fjetje dhe Mëngjes” mbështetja financiare do të jetë deri në 50 % të koston (përfshirë TVSH), me një maksimum prej 5,000 US \$ për aplikim. Mekanizmi i pagesave, përfshirë dhe pagesën nga pronarët e shtëpive/përfituesit është sqaruar në vijim:

•Kësti i Parë: 30 % e koston totale për vlerën e nënprojektit deri në 10.000 US\$ (përfshirë TVSH), ose e gjithë shuma mbi 7,000 US\$ kur vlera totale e nënprojektit kalon 10,000 US\$ (përfshirë TVSH), do të kontribuohet nga përfituesi/Pronari i shtëpisë me qëllim blerjen e materialeve dhe fillimin e punimeve, që do të ndërmerren nga një ndërtues i kontraktuar nga Pronari i shtëpisë dhe i përzgjedhur nga lista e kontraktuesve të pranueshëm, që jepet në paketën e Marrëveshjes së Financimit. Bashkëfinancimi i përfituesit është plotësuar.

•Kësti i Dytë: Pas inspektimit të Inspektoreve (staf i Kompanisë Konsulente, të kontraktuar nga Projekti për hartimin e Projekteve të Konservimit dhe Supervizimin e punimeve për Programin Ç&F dhe F&M), që do të verifikojnë përshtatshmërinë e

- 1) materialeve të blera (dhe punimeve, nëse kane filluar filluar 2) grafikut të punimeve dhe 3) pajtueshmërinë me

•Në Këstin e Dytë e të Tretë, që paguhet nga Programi, nga PCU do të mbahen 5 % të shumës së financimit për Periudhën e Rehabilitimit të Defekteve (3 muaj) dhe që do të paguhet vetëm pas lëshimit të Çertifikatës Përfundimtare për punimet.

klauzolat e tjera të Marrëveshjes së Financimit (cilësia e punimeve dhe pajtueshmëria me direktivat e Manualit të Konservimit), 40 % e koston totale për vlerë të nënprojektit deri 10.000 US\$ (përfshirë TVSH), ose shuma prej 4,000 US\$, kur vlera totale e nënprojektit kalon 10,000 US\$ (përfshirë TVSH), do të transferohet nga Programi Ç&F në Llogarinë Bankare të Pronarit të shtëpisë. Pronari i shtëpisë nga ana e tij është i detyruar të paguajë Kontraktorin për punimet e përfunduara.

•Kësti i Tretë: Gjate punimeve do të kryhen kontrole nga Inspektoret e kontraktuar (minimumi dy) dhe pas përfundimit me sukses të punimeve dhe dorëzimit të tyre sipas grafikut, 30 % e koston totale për vlerë të nënprojektit deri 10.000 US\$ (përfshirë TVSH), ose shuma prej 3,000 US\$ kur vlera totale e nënprojektit kalon 10,000 US\$ (përfshirë TVSH), transferohet nga Programi “Çatitë dhe Fasadat” në Llogarinë Bankare të Pronarit të shtëpisë. Pronari i shtëpisë nga ana e tij është i detyruar të paguajë Kontraktorin për punimet e përfunduara.

Mekanizmi i pagesave do të jetë, gjithashtu, pjesë e Marrëveshjes së Financimit (trepalëshe), që do të firmoset ndërmjet Pronarit të shtëpisë, Zv/Ministrit të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Zyrtari i Autorizuar për Projektin) dhe Kryetarit të Pushtetit Lokal përkatës.

Kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes për Programin “Çatitë dhe Fasadat”

- Banesa është përfaqësuese e arkitekturës tradicionale të vendit
- Të mos ketë më shumë se 20% ndërhyrje moderne (stil dhe material)
- Kushte strukturore të pranueshme për ndërhyrje
- Pronari/ët zotërojnë një titull të qartë të pronësisë: Certifikata e Pronësisë ose një titull provizor: Vërtetim i Pronësisë
- Ne rast të pronësisë të shumëfishtë, duhet të dorëzohet një marrëveshje e nënshkruar nga të gjithë pronarët.
- Formulari i aplikimit duhet të plotësohet si duhet
- Pronari duhet të ketë një Llogari Bankare.
- Të ketë demonstrim pamor/dukshmëri
- Të jetë e banueshme në më shumë se 50 % të vitit
- Preferohet afërsia me aplikimet e tjera

Në shtesë të kriterëve të mësipërme, impakti visual nga rinovimi i përgjithshëm i peizazhit do të merret në konsideratë në procesin e përzgjedhjes.

Kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes për Programin “Fjetje dhe Mëngjes”

- Banesa është përfaqësuese e arkitekturës tradicionale të vendit
- Banesa duhet të ketë strukturë në gjendje të mirë dhe çati e fasada në kushte të mira
- Banesa duhet të ketë më shumë se një dhomë gjumi dhe të jetë e banuar gjatë gjithë vitit.
- Banesa duhet të ketë një kuzhinë ose shërbimet bazë për gatim
- Pronari/ët zotërojnë një titull të qartë të pronësisë: Certifikata e Pronësisë ose një titull provizor: Vërtetim i Pronësisë
- Formulari i aplikimit duhet të plotësohet si duhet
- Pronari duhet të ketë një Llogari Bankare
- Pronari duhet të jetë dakord të marrë pjesë në trajnimin për “Fjetje e Mëngjes”.

Shënimi:

-Nëpërmjet IT Vlora Programi ofron mbështetje për aplikantët (nëse nevojitet) për marrjen e titullit të përkohshëm të pronësisë (Vërtetim i Pronësisë) nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP). Të gjitha kostot, që shoqërojnë marrjen e Vërtetimit të Pronësisë janë detyrim i pronarit të shtëpisë.

-Duke konsideruar faktin që shumica e pronareve të shtëpive në juridiksion të Pushteteve Lokale të përzgjedhura nuk zotërojnë dokumente të qarta pronësie, për të mos penguar zbatimin e Programit "Ç&F", Bashkia/Komuna përkatëse do të konfirmojë, nëpërmjet një deklarate, pronësinë e aplikuesve për Programin "Ç&F". Por, aplikantët duhet të nxiten për t'u angazhuar në procesin e nevojshëm për marrjen e titullit të pronësisë.

Aplikimi për financim dhe shqyrtimi

Formulari për Shprehjen e Interesit (Formulari i Paravlerësimit) duhet të paraqitet në formën e kërkuar dhe të përfshijë fotografi të kohëve të fundit të banesës, informacionin dhe dokumentet e kërkuara (shih aneksin bashkëlidhur). Ju lutemi, respektoni afatin e caktuar për dorëzimin e Shprehjeve të Interesit.

Formulari për Shprehjen e Interesit dhe broshura udhëzuese mund të gjenden dhe të shkarkohen edhe nga faqja zyrtare e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit: www.mppt.gov.al, Bashkisë Himarë: www.himara.gov.al dhe Komunës Lukovë: www.lukova.gov.al, duke klikuar linkun: www.cati-fasada.com. Ekipi i Zbatimit në Vlore, mbështetur, dhe nga OJF (Organizata Jo Fitimprurëse) "ASSA Zeitgeist" (Konsulent i kontraktuar nga Projekti), asiston aplikuesit për të plotësuar Formularin e Shprehjes së Interesit, nëse është e nevojshme, për t'u siguruar që janë plotësuar të gjitha të dhënat e kërkuara. Kjo ndihmë do të përfshijë, gjithashtu, mbështetjen, nëse kërkohet, për hapjen e një Llogarie Bankare personale për aplikuesin. Formularët për Shprehjen e Interesit mund të grupohen nga Komitetet Lokale të "Çative dhe Fasadave" dhe dorëzohen tek IT Vlora (shih informacionin për kontakt) ose mund të dorëzohen nga vetë pronarët tek IT Vlora.

Referuar Shprehjeve të Interesit të dorëzuara dhe vizitave në terren, IT Vlora, me mbështetjen e Kompanisë së Projektimit "Arkimade" (Konsulent i kontraktuar nga Projekti për hartimin e Projekteve të Konservimit), plotësojnë Formularët e Analizës Paraprake/Teknike, nga ku përcaktohen dhe aplikuesit, që mund të procedojnë më tej. Këtyre aplikuesve ju shpërndahen "FORMULARET E APLIKIMIT" për plotësim dhe Letra e Angazhimit për t'u firmosur. Paketa e plotë, që përmban formularët e plotësuar, Projekt Idenë dhe një Kosto Paraprake, si dhe me Letrën e Angazhimit të firmosur, i dorëzohen Komiteteve të miratimit të Nënprojekteve (KNP/SPC), të ngritura në Bashkinë Himarë dhe Komunën Lukovë, KNP shqyrton tërësinë e aplikimeve, pajtueshmërinë me të gjitha kërkesat dhe në përfundim, dorëzon një raport në Njësinë e Koordinimit të Projektit (PCU e ICZMCP), e cila do të deklarojë vendimin e saj. KNP përbehet nga anëtarë të Komiteteve Lokale të "Çative dhe Fasadave", Specialisti Teknik dhe Eksperti i Mobilizimit të Komunitetit, pranë Ekipit të Zbatimit Vlorë. Për të shmangur konfliktet e interesit, anëtarët e KNP, nuk do të jenë të pranueshëm për financim nga Programi "Çatitë dhe Fasadat". Koha për shqyrtimin e aplikimeve (nga Komiteti i Nënprojekteve) mund të zgjasë deri në 15 ditë nga dita e dorëzimit të aplikimeve. Aplikantëve do t'u jepet përgjigje me shkrim dhe do të njoftohen, gjithashtu, dhe nëpërmjet publikimit në Bashkitë/Komunat përkatëse. Për aplikimet e pranuar/miratuara vazhdohet me përgatitjen e Projekteve të Detajuara. Pas përfundimit dhe miratimit të Projekteve lidhet kontrata me Kompaninë e Ndërtimit të përzgjedhur, firmoset Marrëveshja e Financimit (Tripaleshë) dhe fillojnë Punimet e Ndërtimit, sipas kontratës së firmosur ndërmjet Pronarit të Shtëpisë dhe Ndërtuesit. Fondet do të lëvrohen në Llogaritë Bankare të përfituesve/Pronarëve të Shtëpive, në përputhje me mekanizmin e specifikuar në Marrëveshjen e Financimit dhe të sqaruar dhe në këtë broshurë.

Fazat e Aplikimit

Programi "Çatitë dhe Fasadat" është kërkesë e drejtuar dhe procedon me thirrjet për aplikime çdo 3 muaj në secilën Bashki/Komunë të përzgjedhur. Afati për dorëzimin e Shprehjeve të Interesit, që në momentin e thirrjes së radhës, do të jetë 30 ditë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
PROJEKTI “MENAXHIMI I INTEGRUAR DHE PASTRIMI I ZONËS BREGDETARE”

Programi “Ruajtja dhe Zhvillimi i Fshatrave Bregdetare”
Programi “ÇATITË DHE FASADAT”



PËR PËRDORIM ZYRTAR NGA IT VLORA

Dorëzuar me: _____

Dorëzuar nga: _____

Nr.i Regjistrimit: _____

Komente: _____

F O R M U L A R
I SHPREHJES SË INTERESIT

(Formulari i Paravleresimit - Per t'u plotesuar nga aplikuesi me shkronja kapitale)

I. I. Informacion mbi Aplikuesin:

Emri, Mbiemri: _____

Adresa: _____ **Telefoni:** _____ **Celulari:** _____

E-mail: _____

Pronar i vetëm: Po ☐ Jo ☐

Pronësi e Përbashkët: Po ☐ Jo ☐

Në rast të Pronësisë së përbashkët ju lutem dorëzoni bashkëlidhur marrëveshjen e firmosur nga të gjithë pronarët.

Vërtetim mbi Pronësinë: Certificate Pronesie ☐

Dokument Provizor/Vërtetim Pronësie ☐

Janë këto dokumenta bashkëlidhur me aplikimin: Po ☐ Jo ☐

Llogari Bankare: Po ☐ Jo ☐

II. Për çfarë Programi po aplikoni:

1.Çatitë dhe Fasadat (C&F) ☐

1.1Informacion mbi Ndërtesën:

Viti i ndërtimit: _____

Rikonstruksioni i fundit: _____

Sipërfaqja në m² _____

Numri i kateve _____

Përdorim për banim: Po ☐ Jo ☐

Përdorim komercial: Po ☐ Jo ☐

Aktualisht në përdorim: Po ☐ Jo ☐

1.2 Të dhëna për punimet e konservimit:

a.Ndërhyrja e parashikuar:

b.Kostoja e parashikuar për ndërhyrjen:

c.Sa kohë mendoni të zgjasin punimet e konservimit/ruajtjes:

2. Fjetje dhe Mengjes (F&M)

Është struktura e shtëpisë e fortë?

[]

Po [] Jo []

Është çatia dhe fasada në kushte të mira?

Po []

Jo []

Sa dhoma gjumi ka shtëpia?

[]

Është shtëpia e zënë /banuar gjatë gjithë vitit?

Po []

Jo []

Ka shtëpia një guzhinë/kushtet bazë të gatimit?

Po []

Jo []

a. Pse jeni të interesuar për t'u përfshirë në Programin "Fjetje dhe Mëngjes"(F&M):

b. Çfarë mendoni të rikonstruktoni:

c. . Kostoja e parashikuar:

d. Çfarë përfitimesh mendoni se do te keni nga Programi "Fjetje dhe Mëngjes"(F&M):

III. Bashkefinancimi i Aplikuesit:

Jeni dakord të bashkëfinancoji Programin?

Po []

Jo []

IV. Projekt. A jeni ne dijeni te faktit që Programi "Çati dhe Fasada" (C&F) ka kontraktuar një Kompani Projektimi, e cila harton Projektet e Konservimit (Arkitekturor dhe/ose Inxhinierik), planet Arkitekturore për adaptimin e brendshëm për pjesmarrësit në Programin "Fjetje dhe Mëngjes" (F&M) dhe inspektimin e punimeve gjatë zbatimit dhe që pronarët e shtëpive nuk paguajnë për koston e Projektit?

Po []

Jo []

V. Ndërtimi. A jeni në dijeni të faktit që Kompania, e licencuar dhe e kualifikuar për të kryer punimet e konservimit/ruajtjes në banesat me vlera te arkitekturës tradicionale, do të kontraktohet nga ju (vetë pronari) për punimet, që do të kryhen?

Po []

Jo []

VI. Marrëveshja e Financimit. A jeni në dijeni te faktit që pas firmosjes së kontratës për punimet do të firmoset një Marrëveshje Financimi (trepalëshe) midis Pronarit të shtëpisë, Zv/Ministrit të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Zyrtari i Autorizuar për Projektin) dhe Kryetarit të Pushtetit Lokal përkatës?

Po []

Jo []

Data: _____

Nënshkrimi i Aplikuesit _____

Shënim: Bazuar në gjetjet/rezultatet e raundeve paraardhëse/thirrjeve për aplikim për Programin "Çatitë dhe Fasadat", "Fjetje dhe Mëngjes", në raundet në vijim mund të përfshihen ndryshime te vogla në Program si dhe në procedurat e tij të aplikimit.



Afati për dorëzimin e Shprehjeve të Interesit në përgjigje të thirrjes së Katërt, është 18 Gusht, 2012

Informacion për kontakt:

Programi “Ruajtja dhe Zhvillimi i Fshatrave Bregdetare”
Ekipi i Zbatimit Vlorë (IT Vlorë)

L. Pavarësia, Rruga “Pelivan Leskaj”, Kati II (pranë Bankës Credins), VLORË
Telefon: 033 601048

E-mail: itcvcd@abcom.al; itcvcd@gmail.com;